



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.09.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik për vitin 2018 për projektin “Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në Bashkimin Europian në sektorin ekonomik””.

2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”.

3. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Edmond Leka, Alket Hyseni, Bashkim Fino, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Andi Përmeti, Ediola Braha, Aurora Mara dhe Elda Hoti.

Mungon:

Korab Lita, Klotilda Bushka, Damian Gjiknuri, Spartak Braho, Alban Zeneli, Adriatik Alimadhi dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Dajna Sorensen – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Tedi Bushaj – Shef sektori

Arbjan Mazniku – Zëvendëskryetar i Bashkisë së Tiranës

Alban Dokushi – Drejtor i Përgjithshëm Juridik i Aseteve dhe Licencimit

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve të ditës së sotme. Kuorumi plotësohet për të vazhduar me shqyrtimin e tri projektligjeve që kemi në rendin e ditës: “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”; “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban” dhe “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik për vitin 2018 për projektin “Mbështetje për negociatat për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian në sektorin ekonomik””.

Në shqyrtimin e të tria projektligjeve komisioni ynë është komision për dhënie mendimi.

Fillojmë me shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik për vitin 2018 për projektin “Mbështetje për negociatat për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian në sektorin ekonomik””.

Relator do të jetë kolegu Edmond Leka. Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë kemi prezente zonjën Dajna Sorensen, zëvendësministre, dhe zonjën Eralda Shtylla.

Zonja Sorensen, mirë se erdhët në Komisionin e Ligjeve!

Do t’ju lutesha të na bënit një prezantim të marrëveshjes shumë shkurtimisht për kolegët e komisionit. Pastaj do t’ia japim fjalën zotit Leka.

Fjala është për ju.

Dajna Sorensen – I nderuar zoti kryetar i komisionit,

Të nderuar deputetë,

Është kënaqësi që ndodhem sërish këtu për të prezantuar projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik për projektin “Mbështetje për negociatat për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian në sektorin ekonomik””.

Bëhet fjalë për një projekt të asistencës teknike, i cili është në vlerën 2 milionë euro në totalin e tij, që është realisht 100% asistencë teknike për elemente, që kanë të bëjnë me

mbështetjen e Shqipërisë deri në vitin 2022 në kuadrin e negociatave për disa prej kapitujve që kanë të bëjnë me çështjet ekonomike.

Për sa u përket fushave ku presupozohet se do të ketë asistencë teknike, ato janë: zhvillimi i kapaciteteve, i metodologjive dhe i instrumenteve të punës, që do të jenë kaq të nevojshme gjatë procesit të negociatave; puna parapërgatitore për të adresuar kushtet potenciale për hapjen dhe në një pikë të caktuar për mbylljen e negociatave për kapituj të caktuar, sikurse edhe një sërë konsultimesh që do të duhen, veçanërisht me shoqërinë civile dhe me aktorët e tjerë, të cilët do të jenë të domosdoshëm në kuadrin e negociatave.

Ky është thelbi i marrëveshjes.

Për sa i përket anës financiare, angazhimi i palës shqiptare për këtë grant është në vlerën 65 mijë euro, që është vetëm rimbursim i TVSH-së.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Sorensen!

Fjalën e ka zoti Leka.

Edmond Leka – Faleminderit, zoti kryetar!

Informacioni që zëvendësministrja solli ishte shterues. Projektligji i propozuar ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për një investim rreth 2 milionë euro, ku qeveria shqiptare merr përsipër pagimin e TVSH-së rreth 65 mijë euro, në mos gaboj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sa ishte 65 mijë euro apo 650?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk dua të gaboj, pasi kishte dy informacione.

Gjithashtu, në këtë marrëveshje përcaktohen qartë edhe detyrimet dhe shërbimet e palëve.

Duke qenë se nga ana procedurale është në përputhje me Rregulloren e Kuvendit dhe Kushtetutën e vendit, i ftoj kolegët ta miratojmë në komision.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Leka!

Ka pyetje nga kolegët? Nuk ka.

Ka diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim të këtij projektligji.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik 2018 për projektin “Mbështetje për negociatat për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian në sektorin ekonomik””.

Kalojmë në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen të projekt marrëveshjes.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit. Kush është dakord në tërësi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe në tërësi projektligji.

Relatori, zoti Leka, të bëjë gati raportin që t’ia përcjellim komisionit përgjegjës të Kuvendit dhe më pas seancës plenare.

(Deputeti Shameti ndërhyr pa mikrofon.)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.09.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i Projektligjit “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Edmond Leka, Alket Hyseni, Bashkim Fino, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Andi Përmeti, Ediola Braha, Alban Zeneli, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Elda Hoti dhe Tom Doshi.

Mungon:

Damian Gjiknuri.

Të ftuar:

Dajna Sorensen – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Tedi Bushaj – Shef sektori

Arbjan Mazniku – Zëvendëskryetar i Bashkisë së Tiranës

Alban Dokushi – Drejtor i Përgjithshëm Juridik i Aseteve dhe Licencimit

Ulsi Manja – Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës: shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”.

Edhe për këtë projektligj jemi komision për dhënie mendimi. Relatore do të jetë kolegja Aurora Mara. Nga Ministria e Financave kemi përsëri zonjën Sorensen, zëvendësministre, ndërsa nga Bashkia e Tiranës kemi zotin Arbjan Mazniku, nënkryetar, dhe zotin Dokushi, drejtor i Përgjithshëm Juridik.

Mirë se erdhët në komision, zoti Mazniku dhe zoti Dokushi!

Ju lutem, zonja Sorensen, na bëni një prezantim të shkurtër edhe të kësaj marrëveshjeje.

Dajna Sorensen – Faleminderit!

Për sa u përket detajeve teknike të marrëveshjes, ndoshta mund t’ia kalojmë fjalën nënkryetarit të Bashkisë, ndërsa për sa u përket termave financiarë bëhet fjalë për një kredi në vlerën 8 milionë...

Ulsi Manja – Zoti Mazniku, fjala është për ju për të bërë një prezantim të shkurtër të projekt marrëveshjes.

Arbjan Mazniku – Bëhet fjalë për mundësimin e krijimit të një projekti shumë të rëndësishëm për qytetin e Tiranës, që është rehabilitimi i lumit Lana nga segmenti që njihet si “Pallati me shigjeta” deri në hapësirën ku Lana takohet me Unazën e Re.

Një pjesë e shumë qytetarëve nuk e dinë, por në atë pjesë të këtij lumi, megjithëse është në mes të qytetit, Lana rrjedh në gjendje plotësisht natyrore, pra rrjedh me një shtrat të pasistemuar. Zona është urbanizuar tashmë në të dyja krahët. Pra, lumi është linja ndarëse ndërmjet njësive 6 dhe 7, relativisht e ndërtuar, me njerëz që banojnë, por me probleme të mëdha, me përmytje gjatë kohës së shirave, duke qenë se shtrati i lumit është i pasistemuar.

Projekti që do të bëhet ka një gjatësi rreth 2,1 kilometra. Ajo zonë do të rehabilitohet dhe do të bëhet njësoj si pjesa tjetër e Lanës, që do të thotë se kemi një shtrat të sistemuar të lumit me skarpate të gjelbëruara; në të dyja krahët do të kemi tri korsi kalimi mjeteesh në secilin prej krahëve, një korsi të dedikuar autobusi; trotuare në të dyja krahët; korsi e dedikuar biçikletash që do t’i japin mundësinë qytetit që të ketë një zonë shumë të madhe, shumë të gjatë të sistemuar mirë.

Marrëveshja është shumë e mirë. Kemi një kredi prej 8 milionë eurosh, nga ana tjetër kemi 2,4 milionë eurosh, që janë grant i drejtpërdrejtë, dhe një grant tjetër prej 500 mijë eurosh,

i cili është miratuar tashmë si asistencë teknike për pjesën e projektit. Kjo do të thotë që në tërësi është një marrëveshje shumë e mirë edhe në termat financiarë, sepse, përveç kredisë që, gjithashtu, është me terma shumë të favorshëm, kemi edhe një grant me një vlerë goxha të qenësishme.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Mazniku!

Fjalën e ka relatorja, zonja Mara.

Aurora Mara – Faleminderit, zoti kryetar!

E falënderoj zotin Mazniku për sqarimin, i cili ishte shumë i qartë dhe i saktë!

Gjithsesi, do të bëj një rezymë të të dyja projektligjeve, qoftë për atë për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve dhe për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve.

Do t'i përmbledh në një relacion, sepse qëllimi është i njëjtë.

Nëpërmjet këtij projektligji synohet ratifikimi i kontratës financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, siç e shpjegova, dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”. Kredia, që akordohet nëpërmjet kësaj kontrate, kap shumën 8 milionë euro, maturimi është për 20 vjet me interes të përcaktueshëm mbi bazën e tregut në momentin e disbursimit, duke përfshirë një periudhë pa pagesë principali prej katër vjetësh.

Për bashkëfinancimin e këtij projekti Banka Europiane e Investimeve akordon, gjithashtu, një grant në shumën 2,4 milionë euro. Nëpërmjet këtij financimi synohet të realizohet zgjatimi i bulevardit nga Ura Teknologjike, ku përfundon aktualisht segmenti ekzistues, deri në kryqëzimin me rrugën “Teodor Keko” dhe rehabilitimin e shtratit të lumit Lana po për këtë segment.

Nëpërmjet këtij projekti mundësohet krijimi i një shtrati me regjim hidraulik eficient për të eliminuar problematikën e përmytjeve, siç e shpjegoi edhe zoti Mazniku, si dhe për krijimin e hapësirave të nevojshme të zhvillimit urban të zonës.

Rehabilitimi i lumit Lana në këtë segment dhe ndërtimi i zgjatimit të dy bulevardeve “Bajram Curri” dhe “Gjergj Fishta” do të ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e kësaj zone, duke siguruar një infrastrukturë të qëndrueshme, e cila do t'u shërbejë edhe zonave përreth saj, duke përmirësuar gjendjen tejet të amortizuar të infrastrukturës ekzistuese.

Ngarkohen Bashkia e Tiranës dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e të dyja projektligjeve deri në shkurt të vitit 2022.

Nisur nga plani i veprimit dhe i implementimit të këtij projekti, vlera që do të mbulohet nga shpenzimet buxhetore të Bashkisë së Tiranës do të jetë e shpërndarë në tre vjet buxhetorë, duke nisur që nga viti buxhetor aktual.

Duke qenë se për sa i përket aspektit ligjor projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi dhe për sa i përket aspektit procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren, si relatore vlerësoj rëndësinë e miratimit të këtij projektligji dhe u kërkoj kolegëve ta miratojmë atë në komision.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Mara!

Ka pyetje nga kolegët? Po, zoti Leka.

Edmond Leka – Kam një pyetje teknike. Dua të di: a do të ketë devijime nga shtrati aktual i Lanës?

Arbjan Mazniku – Siç edhe e thashë, shtrati aktual i Lanës rrjedh në gjendje natyrore, çka do të thotë se nuk ekziston një gjë që quhet “shtrat i Lanës”. Nga ana e projektuesve është siguruar që ne të tentojmë, sa herë është e mundur, që t’i qëndrojmë asaj që shtrati është sot, por shtrati i Lanës, duke qenë në gjendje natyrore, pas një seri shirash ai mund të lëvizë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por ne do të tentojmë në mënyrë maksimale të përdorim sa më shumë tokë publike, pra tokë që çon...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Projekti inxhinierik është i miratuar. Kanë qenë të paktën në dy planet e fundit urbanistike dhe është i njëjti plan, e njëjta gjurmë lëvizëse.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtu kemi të bëjmë kryesisht me një fushë inxhinierike, por e sigurt është që e gjithë pjesa e pronave ose e banorëve, që mund të preken nga kjo gjë do të menaxhohet në mënyrë shumë të kujdesshme.

Duhet të jemi të sigurt që një pjesë e territorit në çdo rast rreth e qark lumit të Lanës është e prekur nga banesa informale, por që janë edhe në përputhje me ligjin e legalizimeve, janë në një afërsi të tillë me lumin, që nuk do të ishin në asnjë rast të kualifikueshme për procesin e legalizimit, pasi janë në zonë të rrezikshme. Por siç është traditë në Bashkinë e Tiranës, do të sigurohemi që ata të kenë banesa më të mira sesa ato që kanë dhe të kenë mundësi të kenë një proces rialokimi.

Mund të them se një pjesë e madhe e pjesës tjetër të mbështetjes teknike prej 500 mijë eurosh, që banka ka ofruar po shkon ekzaktësisht për një program të mirëfilltë rialokimi për banorët informalë që preken nga kjo gjë.

Duhet thënë se këtë procedurë e ndjekim që prej një viti dhe do të ketë një mekanizëm shumë të mirë për ta zgjidhur si problem.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Mazniku!

Ka pyetje të tjera nga kolegët?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Xhafaj, keni pyetje?

Fatmir Xhafaj – Unë e kam pyetjen të drejtpërdrejtë.

Në medie, në publik ka qarkulluar një tezë që do të ketë një zhvendosje nga shtrati natyror i lumit të Lanës, kjo ka qenë edhe një akuzë publike, për shkak të interesave klienteliste. A ka gjë në këtë rast...

Arbjan Mazniku – Absolutisht jo!

Fatmir Xhafaj – ...që përputhet me këtë akuzë publike që është bërë dhe si qëndron e vërteta e kësaj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Po, zoti Mazniku.

Arbjan Mazniku – Atëherë, për ta shpjeguar më qartë, plani i miratuar dhe gjurma ekzistojnë në të paktën dy plane urbanistike të mëparshme dhe ndjek në mënyrën më të mirë të mundshme rrjedhën natyrore të lumit, duke marrë parasysh këtu faktin, siç e thashë edhe më parë, që kemi të bëjmë me një lum, i cili ka lëvizur në mënyrë natyrore për shumë kohë. Kjo do të thotë se nuk ekziston një shtrat i mirëfilltë i aprovuar i lumit.

Ajo do ta ndjekë atë në mënyrën më të mirë të mundshme.

Kushdo që mund ta shohë, në fakt, mund ta kisha sjellë një imazh të projektit, duket qartë se ajo tenton të ndjekë të gjithë vijën e lumit. Por, për të qenë plotësisht të saktë, lumi ka disa pika ku merr kthesa 180 gradë. Pra, ecën, merr një “U”, kthehet plotësisht kështu, ka një pikë tjetër që kthehet prapë në “U”. Ne do të tentojmë që sa të jetë e mundur, të mbajmë një vijë relativisht të drejtë të lumit. Pa dyshim, në këtë linjë, ashtu siç ka qenë në mënyrë sistematike projekti, ka prona që preken, që nuk janë te shtrati i lumit.

Siç e thashë, në disa momente lumi afrohet deri në 7-8 metra, ngushtohet nga banesat që janë përqark saj. Projekti, për të cilin flasim, është 70,7 metra nga cepi në cep. Kjo do të thotë që ndërmjet trupit të vetë lumit, dy skarpateve të gjelbëruara dhe dy krahëve me rrugë,

është 70,7 metra nga njëri cep në tjetrin, që do të thotë se kemi një sipërfaqe shumë të madhe të prekur.

Por, për t'iu përgjigjur pyetjes në mënyrë të drejtpërdrejtë, në asnjë moment nuk ka një ndryshim të projektit ose të gjurmës për çdolloj interesi apo çdolloj vëmendjeje.

Adnor Shameti – Interes?! Kujt i qëllon aty në krah... Rruga do të zhvillohet pastaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Xhafaj ka një pyetje tjetër.

Fatmir Xhafaj – Kam një pyetje për Ministrinë e Financave, e cila është negociatore e kësaj kredie. Pyetja ime është: a kishte gjëra më madhore për të negociuar, për të marrë kredi Ministria e Financave, apo ky ishte prioriteti i prioriteteve që ka Tirana? Lumi Lana, apo ka gjëra të tjera që mund t'i negociojë për të marrë kredi, që do të paguhen nga taksat e shqiptarëve? Mos vallë Banka Botërore ka qenë vetvetiu e interesuar për ta zhvilluar Lanën, e thënë ndryshe?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndjesë, Banka Europiane e Investimeve!

Ulsi Manja – Cila është përgjigjja nga Ministria e Financave?

Tedi Bushaj – Kredi janë të gjitha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arbjan Mazniku– Jo, njëra është grant, tjetra është kredi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

Tedi Bushaj – Qeveria shqiptare ka edhe prioritete të tjera lidhur me marrjen e kredive nga donatorë të ndryshëm. Në rastin konkret, dje në Komisionin e Ekonomisë kemi kaluar projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes me Bankën Botërore për zhvillimin e tregtisë dhe lehtësimin e transportit në Ballkanin Perëndimor. Besoj se Ministria e Financave u është përmbajtur kushteve të tregut për interesat e përcaktuara edhe nga Banka Europiane e Investimeve.

Ulsi Manja – E ka kërkuar Bashkia e Tiranës këtë negociim, këtë kredi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Pyetjen e kam për Ministrinë e Financave: në qoftë se do të merrni kredi në interes të shtetit shqiptar, të cilën do ta paguajnë qytetarët shqiptarë në vite, do të zgjidhni disa prioritete. Ky është prioriteti që kishte Ministria e Financave për Tiranën?

Adnor Shameti – Pak më saktë, kush e përcakton prioritetin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

Cili është mendimi i përfaqësuesve nga Ministria e Financave?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, një përgjigje: po ose jo.

Dajna Sorensen – Absolutisht, projekti për lumin e Lanës është një ndër prioritetet e shumta. Zona, sikurse e përmendi nënkryetari i bashkisë, preket nga përmbytjet sa herë ka reshje shiu dhe, normalisht, rehabilitimi automatikisht do të përmirësojë cilësinë e jetës së banorëve të asaj zone.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Sorensen!

Arbjan Mazniku – Nëse mund të ndërhyj te kjo pikë...

Ulsi Manja – Po, zoti Mazniku.

Arbjan Mazniku – Banka Europiane e Investimeve ka një program të posaçëm që është ai për përgatitjen e qyteteve në lidhje me ndryshimet klimaterike. Elementet që preken nga përmbytjet kanë qenë një nga prioritetet e tyre.

Arsyeja pse kemi edhe komponentin grant prej 2,4 milionë eurosh përveç kredisë lidhet me një projekt që ka të bëjë specifikisht me çështjen e përmbytjeve.

Nga diskutimet që kemi bërë me bankën, ndër projektet që ka bashkia, kemi projekt realisht të avancuar dhe ka këtë problem (pra ne kemi vuajtur gjatë gjithë këtyre viteve të fundit me situatën e përmbytjeve të banorëve në atë zonë prej reshjeve të shpeshta të shiut), që e përmbushte edhe kriterin e tyre për grantin. Pra, një ndër arsytet pse shkuam drejt këtij projekti, bashkë me ministrinë, sepse negocimi është bërë pothuajse prej dy vjetësh, ishte edhe kombinimi i programit që ka banka për të pasur mundësinë që përveç kredisë të fitonim edhe grantin që nuk është i vogël. Pothuajse 3% e vlerës që është kredi, shkon grant. Pra, nga 8,4 milionë kredi, 2,4 është grant, që është një vlerë relativisht e madhe në raport me kredinë. Ajo shkonte edhe me prioritetet që kishte banka.

Adnor Shameti – Edhe një pyetje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Mazniku!

Fjalën e ka zoti Shameti për pyetje.

Adnor Shameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Kam dy gjëra, që ndoshta janë edhe teknike, edhe shumë sensitive dhe të dukshme për të gjithë opinionin.

E para ka të bëjë... Ju thatë se shkon deri tek ura e vogël, që është ura ekzistuese në Unazë, apo jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, nga ura te “Pallati me shigjeta” deri te një urë e vogël aty, ku kalojnë makinat në Unazë, por nuk e kalon atë matanë, a nuk do të ishte më e udhës, bëhet që bëhet, pra grumbullimi dhe bllokimi që bëhet te “Pallati me shigjeta” tani do ta përplasnit tek ura e Unazës, apo jo, se kështu i bie...

Arbjan Mazniku – Jo.

Adnor Shameti – Deri aty do të zhbllokohet, se pastaj aty njësoj do të ngelet.

Arbjan Mazniku – Jo, është duke...

Adnor Shameti – Ja, ta përfundoj logjikën. A nuk do të ishte e udhës, bëhet që bëhet, që të bëhet tamam dhe të dalë deri te “Casa Italia”, tek ajo ura tjetër, që është në rrugën dytësore...?

Ulsi Manja – Tek “Top-i”.

Adnor Shameti – Po, në të majtë është “Top-i”, dhe ajo e zgjidh.

E dyta, ka edhe lehtësinë, që është e pazhvilluar dhe mund të jetë shumë më e kollajshme për shpronësimet, qoftë për ndërhyrje... Kështu e zgjidh njëherë e mirë. Pra, e bëjmë që e bëjmë, shtrëngohemi për ta bërë tamam një gjë dhe e zgjidhim problemin njëherë e mirë.

Faleminderit!

Arbjan Mazniku – Pa dyshim që do të ishte e udhës, por unë besoj që tashmë kjo është një çështje, për të cilën kemi të paktën 1 vit e gjysmë që negociojmë me bankën dhe me qeverinë që të kemi mundësi ta realizojmë.

Në thelb, kostoja është kosto për njësi. Pra, është kosto për metër që shtohet, është një kosto e madhe.

Zona përtej Unazës, te rruga “Teodor Keko”, është shumë më pak e banuar sesa zona përpara dhe ne tashmë jemi duke investuar shumë para edhe nga buxheti i bashkisë (ju e keni në relacion, pothuajse edhe një herë sa është fondi, janë fondet e alokuara nga buxheti i bashkisë, që është një fond shumë i madh për kapacitetin financiar që bashkia ka), që do të

thotë se kombinimi i të dyjave na jep mundësinë që ky të jetë një ndër projektet më të mëdha infrastrukturore që bashkia do të zbatojë në tre vjetët e ardhshëm.

Do të kishte qenë mirë, por mundësia financiare na limiton deri këtu.

Për sa i përket trafikut, është çështje e zgjidhur, pasi nyjet ku takohet Unaza me...

Adnor Shameti – Nuk e kisha për trafikun, as për urbanizimin e zonës, por më shumë për problemin e përmbytjes.

Arbjan Mazniku – Edhe pjesën e përmbytjes do të fillojmë ta sistemojmë në një linjë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Shameti!

Ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Ka diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për ratifikimin e kontratës financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”.

Kalojmë në shqyrtimin dhe votimin nen për nen të projektligjit.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord në tërësi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe në tërësi projektligji.

Zonja Mara të bëjë gati raportin që t’ia përcjellë komisionit përgjegjës dhe më pas seancës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.09.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Edmond Leka, Alket Hyseni, Bashkim Fino, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Andi Përmeti, Ediola Braha, Alban Zeneli, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Elda Hoti dhe Tom Doshi.

Mungon:

Damian Gjiknuri

Të ftuar:

Dajna Sorensen – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Tedi Bushaj – Shef sektori

Arbjan Mazniku – Zëvendëskryetar i Bashkisë së Tiranës

Alban Dokushi – Drejtor i Përgjithshëm Juridik i Aseteve dhe Licencimit

Ulsi Manja – Kalojmë te pika e fundit e rendit të ditës, ku kemi përsëri një marrëveshje me Bankën Europiane të Investimeve për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillimi urban”.

Komisioni ynë është përsëri për dhënie mendimi. Relatimin e bëri kolegja Mara për të dyja projektligjet. Por dua një prezantim të shkurtër për kolegët lidhur me thelbin e kësaj marrëveshjeje.

Dajna Sorensen – Bëhet fjalë sërish për të njëjtin projekt dhe është vetëm pjesa e grantit në vlerën 2,4 milionë euro, që është e parashikuar në kuadër të këtij projekti, sikurse u përmend edhe nga relatorja.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Sorensen!

Zoti Mazniku, dëshironi të shtoni diçka për marrëveshjen e dytë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk keni ndonjë gjë për të shtuar.

Ka pyetje nga kolegët? Nuk ka.

Ka diskutime? Nuk ka.

Atëherë, e hedhim në votim në parim. Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”.

Kalojmë në shqyrtimin dhe votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord në tërësi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe në tërësi projektligji.

Të përgatitet raporti dhe t'i dërgohet komisionit përgjegjës për miratim që t'i kalojë më pas seancës plenare.

Me miratimin e këtij projektligji, e konsideroj të mbyllur mbledhjen e sotme të Komisionit të Ligjeve.

Faleminderit të gjithëve për pjesëmarrjen!

MBYLLET MBLEDHJA